



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Ftesës publike për aplikim 1-111-7970 e dates 27.02.2017 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË KLUBEVE SPORTIVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të klubeve sportive konform Ftesës publike për aplikim 1-111-7970 e dates 27.02.2017 për ndarje të subvencioneve (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Shaban Sylja, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
3. Albulena Gashi, , Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtare

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për klube sportive, brenda afatit prej 20 dite pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike në pajtim me legjislacionin për financat publike, dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Ftesës publike për aplikim 1-111-7970 e dates 27.02.2017 dhe legjislacionin në fuqi.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 400 - 12217

Lipjan, më 14.03.2017

